



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Obhvety	04.06.2021	1	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendis	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	2892/2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.364/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi -Bajraktari - kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani anëtarë, në bazë të Aktgjykimit A.nr.102/2018 të datës 25.03.2021 të Gjykatës Themelore Departamentit për Çështje Administrative, te pranuar me date 06.05.2021, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A/02/703/2017 të datës 06.11.2017 të parashtruar nga ankuesi

ne adresë Rruga "Rrustim Hyseni", Nr.11/6 në Prishtinë, kundër organit të punësimit Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike „kompozimit material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë shqyrtimin e ankesës të datës 04.10.2017 të parashtruar nga ankuesi në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Obligohet Sekretarit i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, në pozitë „Analistë”, në Departamentin e Analizave dhe Politikave të Sigurisë, sipas Akte emërimit Nr.prot.208/2013 të datës 31.07.2017. Me datën 28.05.2017 i është aprovuar kërkesa nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë për realizimin e udhëtimit zyrtar, për ndjekjen e trajnimit të aftësisimit profesionale, në fushën e sigurisë me temën: “Menaxhimi i Mbrojtjes në kontekstin e gjerë të sigurisë”, të mbajtur në

Akademine e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar në Shkrivenha të Anglisë, prej datës 28.05.2017 deri me datë 15.07.2017.

Ankuesi me datën 17.07.2017 pas kthimit nga udhëtimi zyrtar, ka dorëzuar raportin/dosjen tek zyra e personelit, lidhur me realizmin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar, për ekzekutimin e mëditjeve në pajtim me Udhëzimin administrativ Nr.2004/07.

Ankuesi i pakënaqur me mos pagesën e mëditjeve lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar për trajnimin për aftësim profesionale, të sigurisë me temën: "Menaxhimi i Mbrojtjes në kontekstin e gjerë të sigurisë", të mbajtur në Akademinë e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar në Shkrivenha të Anglisë prej datës 28.05.2017 deri me datë 15.07.2017. Me datë 04.10.2017 ka parashtruar ankese për mes E-mailit zyrtar tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, i cili me datë 10.10.2017 i është përgjigje se nuk ka vendim të formuar të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe se ankesa nuk mund të shqyrtohet deri sa të nxjerrët vendimi nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me mos veprimet procedurale dhe administrative nga ana e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datën 06.11.2017 me numër protokollit 5654/2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për heshtjen administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.12.2017 e me numër të protokollit 6736/2017 merr vendimin me numër A/02/703/2017 me të cilin vendim hedhe poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A/02/703/2017 e datës 06.11.2017 e parashtruar nga ankuesi
Ankuesi Kujtim Bytyqi i pa kënaqur me Vendimin A/02/703/2017 të datës 21.12.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.01.2018 hap konflikt administrativ ndaj vendimit të Këshillit dhe Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datë 25.03.2021 nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.102/2018 me të cilin Aktgjykim aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kujtim Bytyqi dhe anulohet vendimi i Këshillit dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.11.2017 ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Këshilli i Sigurisë së Kosovës për përgjigje në ankesë. Me datë 29.11.2017 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës (faqe 1-21).

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.102/2018 të datë 25.03.2021i Gjykatës Themelore Departamentit për Çështje Administrative në Prishtinë; Procesverbali nga seanca e datë 25.03.2018 i Gjykatës Themelore Departamentit për Çështje Administrative; Aktvendimi i datës 05.04.2019 nga Gjykata Themelore Departamentit për Çështje Administrative; Përgjigje në padi e datës 16.04.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Kërkesë padia e datës 22.01.2018 në Gjykatën Themelore Departamentit për Çështje Administrative; Vendimin me numër A/02/703/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës i datës

21.12.2017; Ankesën me numër A/02/703/2017 e datës 06.11.2017, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; E-maili zyrtar i datës 04.10.2017 adresuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Përgjigje e datës 10.10.2017 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; E-mail i datës 09.10.2017; E-mail i datës 02.10.2017; E-mail i datës 28.09.2017; Ftese për trajnim i datës 18.05.2017 dhe pasqyrën e programit të trajnimit; Kopje e pasaportit; E-mail i datës 03.03.2017; Kërkesë për udhëtim zyrtar e datës 28.05.2017; Pasqyre e bankës ProCredit Bankës i datës 11.04.2017 (faqe1/3); Përgjigje në ankese e datës 29.11.2017; Akte emërimi i datës 31.07.2013; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 13.01.2013; Plani vjetor i trajnimit i nëpunësve civil, nga janari deri dhjetor 2017; E-mail zyrtar i datës 22.11.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për vendosje, duke e obliguar organin e punësimit respektivisht Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë shqyrtimin e ankesës të datës 04.10.2017 të parashtruar nga ankuesi në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, lidhur me ankesën e datës 04.10.2017 të ankuesit Kujtim Bytyqi, ka qenë i obliguar që të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 131 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa kundër një akti administrativ do të shqyrtohet, në radhe të parë nga organi kompetent"*, pastaj neni 135 i po këtij ligji përcakton se: *"Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës"*, si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që përcakton se: *"2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës"* si dhe neni 9 paragrafi 7 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ka përcaktuar se: *"Komisioni duhet të marr vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës"*, rrjedhimisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës është i obliguar që ti shqyrtoj të gjitha provat dhe faktet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë dhe të vendos për ankesën e ankuesit në pajtim me dispozitat e Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave si dhe pajtim me Udhëzimin Administrativ numër 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marr parasysh se kjo procedurë ankimore ka filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe duke u mbështetur në nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, konstatoje se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i themeluar sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, ka mandat ligjor për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të ankuesve, dhe i njëjti duhet të shqyrtojë të gjitha provat dhe faktet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë dhe të vendos për ankesën e ankuesit në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.03/L-149 për

RE
DA-NE
- BILU
DVO
2019

Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, si dhe legjislacionin tjetër përkatës të aplikueshëm në rastin konkret.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Anr.364/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyle Millaku
Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Sekretarit i Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Gjyqtares të Gjykatës Themelore në Prishtë-Departamentit për Çështje Administrative, Znj. Anita Nikqi Morina;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe,
- Arkivoit të KPMSHCK-së

